

**STATUTI I**  
**SHOQERISE TREGTARE**  
**“FIRSTSMILE LAB” SH.P.K.**

**Kreu 1**

**Dizpozita te pergjithshme**

Neni 1

Sipas kerkesave te ligjit numer 9901, date 14.04.2008 “Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe atij numer 9723, date 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, krijohet shoqëria tregtare “FIRSTSMILE LAB” Sh.p.k , e cila do te veproje ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe nenet e ketij statuti.

Neni 2

Ne kete statut termat e meposhtme kane keto kuptime:

Statuti: Statuti i shoqërise me pergjegjesi te kufizuar “FIRSTSMILE LAB” Shpk  
Shoqëria: Shoqëria me Pergjegjesi te Kufizuar “FIRSTSMILE LAB” Shpk  
Ligji Tregtar: Ligji 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”

Në kuptim të këtij statuti, shprehjet në njëjës përfshijnë ato në shumës dhe anasjelltas me përjashtim të rastit kur sipas kontekstit të dispozitës rezulton ndryshe. Përemri vetor “ai” përfshin edhe përemrin vetor “ajo” dhe përemrin vetor “ate”, nënkuptohen të dyja gjinitë me përjashtim te rasteve kur sipas kontekstit të dispozitës rezulton ndryshe.

Të gjitha njoftimet, kërkesat ose komunikimet e tjera që shoqëria i drejton ortakëve sipas këtij statuti, do të bëhen me shkrim dhe do të konsiderohen se janë kryer në mënyrë të rregullt kur dërgohen ortakëve në adresat e deklaruara prej tyre pranë administratorit të shoqërisë.

**Kreu 2**

**Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia**

Neni 3

Sot, me 12.09.2022, une, themeluesi, kam krijuar nje shoqëri me pergjegjesi te kufizuar me emrin FIRSTSMILE LAB Sh.p.k.

Themeluesi i shoqërie “FIRSTSMILE LAB” Shpk eshte:

- Z.Erald Shimaj, i datelindjes 11.09.1997, i biri Arturit, lindur ne Shkoder dhe banues ne Rr. “Mine Peza”, Tirane, i pajisur me karte identiteti me nr. karte **032768213** dhe nr Personal **J70911076L**.

Neni 4

Shoqëria do te kete statutin e nje shoqërie me pergjegjesi te kufizuar.

Neni 5

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete:

- Laborator dentar. Pergatitja dhe tregtimi i aparaturave dentare.

Neni 6

Shoqeria e ka seline e saj ne: Rr. "Mine Peza", Z.K 8350, Nr. Pasurie 1/94+1-1, Godina 16, Ap 1, hyrja 1.

Ajo mund te cele dhe adresa aktiviteti te tjera te dyta, dege e filiale ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise si dhe jashte saj.

Neni 7

Shoqeria do te kete kohezgjatjen e veprimtarise se saj pa afat.

Neni 8

Shoqeria ka vulen e saj.

### **Kreu 3**

#### **Kapitali**

Neni 9

Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte 500,000 (Peseqind mije) leke dhe perbehet nga 1 kuote me vlefte 500,000 leke. Pjesemarrja e ortakeut themelues ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributin e tij te meposhtem:

- Z.Erald Shimaj, i datelindjes 11.09.1997, i biri Arturit, lindur ne Shkoder dhe banues ne Rr. "Mine Peza", Tirane, i pajisur me karte identiteti me nr. karte **032768213** dhe nr Personal **J70911076L**, zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 500,000 leke qe perben 100% te kapitalit themeltar te shoqerise.

Te gjitha kuotat e kapitalit themeltar do te shlyhen me afat deri ne 3 vjet. Kontributi i ortakeve mund te jete ne para ose ne natyre.

Neni 10

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet ose te zvogelohet sipas vendimit te ortakeve.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendime ne te njejtat kushte qe kerkohet per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zmadhimi ose zvogelimi i kapitalit i prek ortaket ne te njejtën mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

#### Neni 11

Ortaku mund të transferojë të tretëve kuotat e tij të kapitalit pjesërisht ose tërësisht. Transferimi i kuotave tek të tretet do të bëhet vetëm pasi të ketë marrë vendim asambleja e ortakëve me shumicë absolute të votave.

Kuotat e kapitalit mund të fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë
- b) shitblerjes
- c) trashëgimisë
- d) dhurimit
- e) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj

#### Kreu 4

##### Organet vendimarrëse dhe drejtuese

#### Neni 12

Organet e shoqërisë do të jenë:

- Asambleja e ortakëve
- Administratori

Fusha e veprimtimit, përberja dhe mënyra e funksionimit të organeve drejtuese rregullohet si më poshtë.

##### Asambleja e ortakëve

#### Neni 13

Asambleja e ortakëve është organi më i lartë vendimor.

Asambleja e ortakëve është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e ortakëve merr vendime sa herë e sheh të arsyeshme, por domosdoshmërisht për të miratuar pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë.

#### Neni 14

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore, shpërndarjen e fitimeve dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;

- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

#### Neni 15

Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose, nese parashikohet nga statuti, me njoftim nepermjet postes elektronike te ortakeve. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas paragrafit te mesiperem te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht kesaj parregullsie.

#### Neni 16

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30% te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit "Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ajo mund te marre vendime te vlefshme, vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votive, jane te pranishem personalisht.

Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumit te permendur me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

#### Neni 17

Asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat ( $\frac{3}{4}$ ) e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per:

- a) ndryshimin e statutit,
- b) zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar,
- c) miratimin e pasqyrave financiare vjetore
- ç) shperndarjen e fitimeve,
- d) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e pergjithshme vendos me shumice te votave te ortakeve pjesemarres, per ceshtje te tjera si:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- dh) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- e) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet ne QKB per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

## Administrimi

### Neni 18

Asambleja e pergjithshme emerone nje ose me shume persona fizike si administrator te shoqerise. Afati i emerimit eshte 5 vjet, me te drejte ripertesitjeje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne QKB.

### Neni 19

Administratori ka te drejte te perfaqesoj shoqerine ne maredhenie me te tretet per permbushjen e aktivitetit te saj ne perputhje me nenin 5 te ketij statuti.

Organi Administrativ (administratori) ka te drejte dhe duhet te:

- a) kryeje me mirebesim te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme e ortakeve e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi;
- b) perfaqesoje shoqerine tregtare;
- c) kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabël te shoqerise;
- ç) pergatit dhe nënshkruajnë pasqyrat financiare vjetore, dhe raportin e ecurise së veprimtarise dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së pergjithshme për miratim;
- d) krijoje një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarise dhe ekzistencën e shoqerise;
- dh) kryeje regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqerise, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportoje përpara asamblesë së pergjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqerise tregtare;
- ë) kryeje detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- f) marre ne pune persona te ndryshem dhe rregullimin e maredhenieve te punes me ta.
- g) perfaqesoje apo emeroje perfaqesues ne ceshtje gjyqesore qe mund te kete shoqeria ose ne ceshtje te tjera me pale te treta;

Nese asambleja e pergjithshme emerone me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkerisht shoqerine, pervec rasteve kur ne vendimin e emerimit shprehet ndryshe. Asambleja e pergjithshme mund te shkarkoje administratorin ne cdo kohe me shumice te zakonshme.

### Neni 20

Administrator i shoqerise "FIRSTSMILE LAB" shpk emerohet Z.Erald Shimaj, i datelindjes 11.09.1997, i biri Arturit, lindur ne Shkoder dhe banues ne Rr. "Mine Peza", Tirane, i pajisur me karte identiteti me nr. karte **032768213** dhe nr Personal **J70911076L**. Afati i emerimit te administratorit do te jete 5 vjet nga data e miratimit te ketij statuti.

## **Kreu 5**

### **Kushtet ekonomike**

Neni 21

Shoqeria eshte pronare, disponuese dhe perdoruese e pasurise se saj. Ajo vepron ne regjistrin e prones si cdo person tjeter juridik ne Shqiperi; mund te bleje, te shese, te jape ne perdorim, etj.

Neni 22

Ne fund te cdo periudhe ushtrimore hartohen pasqyrat financiare sipas ligjeve ne fuqi. Pasqyrat financiare periodike mujore, tremujore, gjashtemujore miratohen e nenshkruhen nga administratori i shoqerise. Pasqyrat financiare vjetore nenshkruhen nga administratori dhe miratohen nga Asambleja e pergjithshme e Ortakeve.

Neni 23

Viti financiar i shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit ne QKB dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 24

Maredheniet e punes ne kete shoqeri rregullohen nepermjet kontrates se punes. Per ceshtjet qe nuk parashikohen ne kete statut do zbatohen dispozitat e Kodit te Punes ne Republiken e Shqiperise. Mosmarreveshjet e punonjesve me shoqerine do te zgjidhen ne gjykatën shqiptare.

## **Kreu 6**

### **Dizpozita te vecanta**

#### **Prishja – riorganizimi I shoqerise**

Neni 25

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe, per shkaqet:

- a) me vendim te Asamblese se Ortakeve per prishjen e shoqerise;
- b) ipas rasteve te parashikuara nga Ligji Tregtar;
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit;
- ç) me vendim te gjykates;

Neni 26

Ne rastin e prishjes se shoqerise, Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar nje ose disa likuidatore.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emeruar nga Ortaket, duke likuiduar ne radhe te pare detyrimet ndaj punonjesve, shtetit e me pas ndaj te treteve. Ne rastin e teprices se kapitalit te shoqerise me perfundimin e likuidimit, kjo i shperndahet Ortakeve.

Nese Ortaket nuk marrin nje vendim per emerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, cdo person i interesuar mund ti drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

Neni 27

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas vendimit te Asamblese se pergjithshme te Ortakeve , ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne ligjin nr. 9901 date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”.

### **Baza ligjore**

Neni 28

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare, Kodi Civil dhe cfaredo ligji tjeter ne Republiken e Shqiperise.

Neni 29

Mosmarveshjet qe mund te lindin midis shoqerise dhe te treteteve, zgjidhen me mirekuptim, ne te kundert palet i drejtohen Gjykates se Republikes se Shqiperise per zgjidhje.

Neni 30

Ky statut u perpilua ne prani te ortakeve te shoqerise duke shprehur vullnetin e tyre te plote e te lire.

Ai u perpilua ne tre kopje me fuqi te barabarta secila, per t’u depozituar ne QKB, per t’u shperndare ne organet kompetente dhe nje kopje mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise.

Tirane me 12.09.2022

**ORTAKU I VETEM I SHOQERISE**  
**“FIRSTSMILE LAB” SHPK**

**Erald SHIMAJ**

Erald Shimaj  
